

Kushtet e përgjithshme të menaxhimit të MTS sh.p.k. për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik celular të komunikimit.

1. Dispozitat hyrëse

1. Këto Kushte të përgjithshme janë kushte të menaxhimit për „MTS“ sh.p.k., d.o.o., me seli në Mitrovicën Veriore, Kosovë, rr. Oslobodjenja numër 1 (në tekstin e mëtejshëm: mts) për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik celular të komunikimit (në tekstin e mëtejshëm: Shërbimet celulare të mts-së).

2. Rrjeti publik celular i komunikimit është rrjet në të cilin pikat terminale nuk gjenden në vendndodhjet fikse. Shfrytëzuesit e shërbimeve, me të cilët kanë të bëjnë këto Kushte të përgjithshme për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik celular të komunikimit të Mts-së (në tekstin e mëtejshëm: Kushtet e përgjithshme) janë parapaguesit dhe shfrytëzuesit e regjistruar pripejd.

3. Kushtet e përgjithshme dhe Lista e çmimeve të mts-së publikisht janë në disponim në pajtim me dispozitat e vlefshme në faqen zyrtare në internet www.mtsdoo.com, si edhe në zyrat dhe në vendet e shitjes së mts-së.

4. Dhënia e secilës nga shërbimet me të cilat kanë të bëjnë Kushtet e përgjithshme, rregullohen përveç Kushteve të përgjithshme edhe me kontratë parapaguese (në tekstin e mëtejshëm: „Kontrata“). Me nënshkrimin e Kontratës, shfrytëzuesi e pranon aplikimin e Kushteve të përgjithshme. Kushtet e përgjithshme aplikohen edhe ndaj marrëdhëniesve të mts-së dhe shfrytëzuesit të shërbimeve gjatë vlefshmërisë së Kontratës dhe janë pjesë përbërëse e Kontratës. Shmangiet nga Kushtet e përgjithshme janë të mundshme vetëm nëse janë përcaktuar me Kontratën e lidhur në formën me shkrim që në emër të mts-së e ka nënshkruar personi zyrtar.

5. Parapaguesit dhe shfrytëzuesit e shërbimeve pripejd në rrjetin celular të mts-së bashkarisht në këto Kushte të përgjithshme emërtohen Shfrytëzues të shërbimeve. Nenet e këtyre Kushteve të përgjithshme me të cilat përcaktohen të drejtat dhe obligimet e Parapaguesit nuk aplikohen ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve pripejd në rrjetin e mts-së.

6. Mts ka të drejtë që në pajtim me ndryshimet e dispozitave të vlefshme, kushteve të dhënies së shërbimeve, politikat e veta menaxhuese dhe nevojat e shfrytëzuesit, i bën ndryshimet dhe plotësimet e Kushteve të përgjithshme, për çfarë ka për detyrë t'i informojë parapaguesit 30 ditë më herët në mënyrë të duhur.

7. Ndaj të gjitha marrëdhëniesve midis mts-së dhe Shfrytëzuesit të shërbimeve të cilat nuk janë rregulluar me këto Kushte të përgjithshme aplikohen dispozitat e ligjit në fuqi dhe të dispozitave nënligjore.

2. Shfrytëzuesit pripejd

1. Kontrata me shfrytëzuesit prapejd lidhet me blerjen e paketës së tarifës prapejd me kartelën SIM në vendet shitëse të mts-së ose të distributorëve të tij. Me blerjen e paketës tarifore prapejd të mts-së dhe me aktivizimin e kartelës SIM shfrytëzuesi e pranon aplikimin e këtyre Kushteve të përgjithshme.
2. Paketa me tarifë prapejd mund të përmbajë kartelën SIM ose kartelën SIM dhe aparatin për përdorimin shërbimeve që janë objekt i këtyre Kushteve të përgjithshme. Përdorimi i shërbimeve fillon nga ana e shfrytëzuesve prapejd me aktivizimin e kartelës SIM.
3. Me kërkesën me shkrim, të shfrytëzuesit të paregjistruar prapejd, bashkë me dokumentin e vlefshëm të identifikimit, si edhe me dërgimin në këqyrje të kartelës SIM dhe të kodit PUK, mts do t'i registrojë të dhënet e tij personale, pas së cilës shfrytëzuesi ka të drejta dhe obligime si Parapagues dhe këtë të drejtë edhe që t'i zëvendësojë: kartelat e dëmtuara SIM, të humbura ose të vjedhura, marrjen e specifikimit të trafikut të realizuar, paraqitjen e reklamimeve, kalimin e të drejtave për kartelën SIM shfrytëzuesit tjetër, si edhe të drejtat e tjera për përdorimin e të cilëve është i domosdoshëm identifikimi i shfrytëzuesit.
4. Shfrytëzuesi prapejd ka për detyrë që në periudhat e caktuara kohore ta bëjë mbushjen e kredisë për numrin e vet. Në të kundërtën, mts ka të drejtë që përkohësisht ta ndërprejë numrin. Në rast se as pas 60 ditësh nga ndërprerja e përkohshme e përdoruesit prapejd nuk e bën mbushjen, numri do të ç'aktivizohet përgjithmonë. Shfrytëzuesit e të gjitha paketave të cilët nuk e bëjnë mbushjen prapejd brenda intervalit kohor i caktuar në specifikim të paketës së tarifës, e humbin kredinë dhe u ç'aktivizohet numri.

3. Lidhja e Kontratës parapaguese postpejd

1. Kompania mts do ta marrë në shqyrtim kërkesën për dhënie e shërbimeve postpejd (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesa) nëse shfrytëzuesi ofron në këqyrje të gjitha të dhënat, dokumentet e identifikimit, autorizimin dhe dokumentet e tjera me të cilat e konfirmon identitetin e shfrytëzuesit. Personi juridik i dërgon dokumentet përkatëse për regjistrim në regjistër përkatës, si edhe të dhënat e tjera të domosdoshme për nënshkrimin e Kontratës. Për shfrytëzues privatë kërkesën mund ta bëjë personi i moshës madhore, kurse për personin e mitur kërkesën mund ta bëjë prindi ose kujdestari. Shfrytëzuesi me paraqitjen e kërkesës për lidhjen e Kontratës e pranon/e jep pëlqimin që mts mund ta verifikojë aftësinë paguese të shfrytëzuesit dhe që në këtë qëllim e bën këmbimin e të dhënave për kryerjen paraprake të obligimeve nga ana e shfrytëzuesit.
2. Kërkesa e shfrytëzuesit do të shqyrtohet me kusht që shfrytëzuesi i ka larë të gjitha borxhet e rregullta ndaj mts-së të cilave u ka skaduar afati për pagim, si edhe që kundër shfrytëzuesit nuk është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore për arkëtimin e kërkesave. Gjithashtu, kundër shfrytëzuesit nuk guxon të ketë filluar procedura e likuidimit ose falimentimit.

3. Paraqitja e kërkesës Mts-së mund të mundësohet edhe në mënyrë elektronike (online) ose përmes ndonjë mjeti tjetër të komunikimit në largësi që mts-në e bën publikisht të pranishëm. Me paraqitjen e Kërkesës në këtë mënyrë, shfrytëzuesi është dakord me përdorimin e mjeteve të komunikimit në largësi ose me qëllim të lidhjes së Kontratës përkatësisht konfirmon se është i njoftuar dhe që pranon që Kontrata midis mts-së dhe Parapaguesit konsiderohet e lidhur me aktivizimin e shërbimit pas procedurës së theksuar. Në rastin e lidhjes së kontratës në largësi dhe kontratës jashtë ambienteve të menaxhimit, mts do ta njoftojë paraqitësin e Kërkesës për të gjitha të dhënat e përcaktuara me dispozita të veçanta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të njëjtit do t'ia dërgojë një ekzemplar të Kontratës, përkatësisht vërtetimin për kontratën e lidhur, sipas mënyrës dhe në formën e përcaktuar me dispozita të veçanta për mbrojtjen e konsumatorit.

4. Me rastin e paraqitjes së Kërkesës, shfrytëzuesi e autorizon mts-në që mundet, brenda afatit prej 30 ditësh, ta bëjë verifikimin e të dhënave lidhur se a ka aftësi paguese parapaguesi. Nëse të dhënat të cilat i merr mts dëshmojnë për paaftësinë e mundshme të parapaguesit ose për faktin që shfrytëzuesi në mënyrë të parregullt po i plotëson obligimet ndaj personave të tretë, mts për këtë do ta njoftojë dhe do të kërkojë deklarin e tij. Pasiqë e pranon deklaratën e shfrytëzuesit ose pas skadimit të afatit për deklarin, mts do të vendosë për lidhjen e Kontratës, me të cilin rast ka të drejtë të refuzojë kërkesën për lidhjen e Kontratës, dhe për këtë ta njoftojë shfrytëzuesin.

5. Përveç nëse me Kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, Kontrata lidhet për kohë të pacaktuar.

6. Kontrata midis parapaguesit dhe mts-së lidhet në formën me shkrim, me nënshkrimin nga ana e parapaguesit dhe përfaqësuesit të autorizuar të mts-së. Kushtet e përgjithshme janë pjesë përbërëse e Kontratës. Me nënshkrimin e Kontratës shfrytëzuesi konfirmon se është i njoftuar dhe që i ka pranuar të gjitha dispozitat e Kushteve të përgjithshme.

7. Me rastin e lidhjes së Kontratës, parapaguesi e zgjedh paketën e tarifës. Emërtimi i paketës së zgjedhur të tarifës dhe përshkrimi i tij gjenden edhe në Kontratë dhe i bashkëlidhet të njëjtës, gjë që e nënkupton se parapaguesi është i njoftuar dhe dakord me të gjitha kushtet dhe që i ka pranuar të gjitha çmimet dhe kushtet për përdorimin e saj.

8. Paketa postpejd e tarifës për të cilën parapaguesi është orientuar në Kontratë mund të përmbajë kartelën SIM ose kartelën SIM dhe aparatën për përdorimin e shërbimeve të cilat janë objekt i Kushteve të përgjithshme.

9. Midis mts-së dhe parapaguesit mund të kontraktohet dhënia e shërbimeve me obligim të veçantë, me periudhë minimale të kohëzgjatjes së obliguar të Kontratës, përkatësisht me periudhë minimale të vlefshmërisë së Kontratës, në të cilin rast vlejné kushtet veçanërisht të përkufizuara, në pajtim me Listën e çmimeve dhe me Kontratën. Me kontraktimin e periudhës minimale të vlefshmërisë së Kontratës parapaguesi i fiton përshtatshmëritë e caktuara, të cilat mund të kenë të bëjnë si me kushtet e veçanta të

përdorimit të shërbimeve ashtu edhe me mundësinë e blerjes së aparateve të domosdoshme për përdorimin e shërbimeve, dhe këtë në pajtim me Kontratën.

10. Parapaguesi postpejd mundet, gjatë periudhës minimale të vlefshmërisë së Kontratës, të kërkojë ndryshimin e profilit të tarifës por vetëm në profilin tjetër të tarifës me kompensim të njëjtë ose më të madh mujor.

4. Aktivizimi i shërbimit, kartela SIM dhe përdorimi i shërbimeve

1. Fillimi i përdorimit të shërbimeve dhe aktivizimi i kartelës SIM mundësohen sipas rregullit menjëherë pas lidhjes së Kontratës, e jo më vonë se 24 orë nga momenti i lidhjes së Kontratës, por që mts e ruan të drejtën që në situata të jashtëzakonshme t'i shtyjë, për jo më vonë se 30 ditë. Mts ua ndan kartelën SIM Shfrytëzuesve të shërbimeve vetëm që t'i përdorin shërbimet celulare në pajtim dhe Kushtet e përgjithshme dhe me Kontratën. Mts e ruan të drejtën e pronësisë mbi kartelën SIM gjatë kohës së përdorimit të shërbimeve nga ana e Shfrytëzuesit të shërbimeve.

2. Shfrytëzuesi i shërbimeve ka për detyrë që me kujdes ta përdorë kartelën SIM me rastin e lidhjes në pajtijen terminale, në pajtim me udhëzimet e prodhuesit, ta ruajë nga fatkeqësitë kohore, dëmet, përdorimi joprofesional dhe jo i autorizuar. Në të kundërtën, Shfrytëzuesi i shërbimeve do të përgjigjet për tërë dëmin e krijuar për shkak të përdorimit të parregullt, joprofesional dhe jo të autorizuar të kartelës SIM të mts-së.

3. Përlllogaritja dhe arkëtimi i shërbimit fillon ditën e aktivizimit të shërbimit në pajtim me Kontratën dhe me këto Kushte të përgjithshme, dhe këtë sipas Listës së çmimeve të Mts-së (në tekstin e mëtejme: Lista e çmimeve).

4. Në rast të humbjes ose vjedhjes së kartelës SIM ose për shkaqe të tjera të cilat mund të shkaktojnë keqpërdorimin, Shfrytëzuesi i shërbimeve ka për detyrë që ta bëjë paraqitjen e përkrahjes së shfrytëzuesit të mts-së duke thirrur, me email ose telefaks, duke shkuar në zyren më të afërt, dhe duke i dhënë patjetër të dhënat e identifikimit të kartelës SIM, numrin e lidhjes dhe të dhënat e tjera të nevojshme për shkak të përcaktimit të bazueshmërisë së lajmërimit. Mts nuk do t'i përgjigjet Shfrytëzuesit të shërbimeve ose cilitdo qoftë personi për dëmin i cili mund të krijohet për shkak të lajmërimit joadekuat ose jo me kohë të humbjes ose vjedhjes së kartelës SIM.

5. Në rast të dëmtimit të kartelës SIM për shkak të përdorimit të parregullt, si edhe në rast të humbjes ose vjedhjes së kartelës SIM, mts me kërkesë të parapaguesit mund ta bëjë zëvendësimin e kartelës me kartelë të re duke e ruajtur numrin parapagues, për çfarë parapaguesi e paguan kompensimin sipas Listës së çmimeve në momentin e zëvendësimit. Në rast të parregullsisë teknike të kartelës SIM mts të njëjtën do ta zëvendësojë pa kompensim.

6. Shfrytëzuesi i shërbimeve e mban përgjegjësinë e plotë për përdorimin e shërbimeve të mundësuar përmes rrjetit publik celular të mts-së, si edhe për dëmin eventual të bërë personit të tretë që është krijuar gjatë përdorimit.

7. Shfrytëzuesi i shërbimeve obligohet që për lidhjen me rrjetin t'i përdorë vetëm instalimet/aparatet të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike, që do t'u

përmbahet të gjitha udhëzimeve për përdorimin e aparatit, se të njëjtat do t'i ruajë në gjendje të rregullt, dhe që nuk do t'ua lejojë personave të tretë përdorimin e këtyre aparateve në kundërshtim me këtë që u theksua.

8. Shfrytëzuesi postpejd me rastin e lidhjes së Kontratës do të njoftohet me kufizimet e veçanta në përdorimin e aparatit në paketën e kontraktuar të shërbimeve.

9. Mts e ruan të drejtën që menjëherë, pa paralajmërim paraprak, t'ia ndërprejë shërbimet shfrytëzuesit, nëse e shkel ndonjë nga dispozitat nga pika 7 e këtij neni, gjë që për pasojë mund të ketë probleme në funksionimin e shërbimit ose dëmin në rrjet.

10. Pas pushimit të vlefshmërisë së Kontratës, shfrytëzuesi ka për detyrë që mts-së t'ia kthejë, në gjendje të rregullt, pajisjen terminale të dhënë për përdorim ose t'ia komensojë të njëjtat sipas Kontratës ose Listës së çmimeve përkatësisht vlerën e tregut nëse e njëjta nuk është përcaktuar me Kontratë ose me Listën e çmimeve në ditën e pushimit të vlefshmërisë së Kontratës.

11. Me kërkesë të Shfrytëzuesit të shërbimeve, mts do t'i ofrojë edhe shërbimet plotësuese nga oferta e vet e shërbimeve, nëse për këtë janë plotësuar kushtet teknike. Përveç nëse me Kontratë është përcaktuar më ndryshe, Kontrata dhe Kushtet e përgjithshme aplikohet edhe ndaj shërbimeve plotësuese. Shërbimet plotësuese faturohen në pajtim me Listën e çmimeve të Mts-së.

12. Mts e mundëson përdorimin e shërbimeve në rrjetat publike celulare të operatorëve të tjerë (roming), duke përfshirë operatorët në botën e jashtme, me të cilët i ka të lidhura kontratat për roming kombëtar ose ndërkombëtar.

13. Të drejtën nga paragrafi i mëparshëm Shfrytëzuesi i shërbimeve e realizon në pajtim me kushtet e paketës tarifore të cilën e përdor dhe me kushtet e operatorit roming në rrjetin e të cilit gjendet.

14. Përdorimi i shërbimeve në roming ua mundëson parapaguesve të cilët rregullisht i paguajnë llogaritë e veta përkatësisht pas pagesës së llogarisë avanse për parapagues të cilët janë në rrjetin mts-së më pak se tre muaj, me të cilin rast mts e ruan të drejtën të përcaktojë edhe afate më ndryshe të lidhjes së shërbimeve roming.

15. Parapaguesi është personi i vetëm që mban përgjegjësi për përdorimin e shërbimeve celulare në roming. Gjithashtu obligohet se me rastin e përdorimit të shërbimeve në roming, do t'i respektojë kushtet e operatorit të këtyre shërbimeve dhe që mts –së do t'ia paguajë shërbimet sipas Listës së çmimeve të mts-së.

5. Të dhënat për shfrytëzuesin e shërbimeve dhe për trafikun e realizuar

1. Mts i grumbullon dhe i përpunon të dhënat personale të shfrytëzuesve, në çdo gjë sipas Ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Mts garanton sekretin e të dhënave personale të Shfrytëzuesit të shërbimeve në kufijtë e dispozitave ligjore të vlefshme. Me të dhënat e theksuara mts mund të veprojë me qëllim të realizimit të Kontratës, kryerjen e obligimeve, të bazuara në ligj, arkëtimin e kërkesave, kurse për qëllime të tjera me pëlqimin e Shfrytëzuesit të shërbimeve.

3. Të dhënat për trafikun janë të lidhura për Shfrytëzues konkret të shërbimeve, përveç me qëllim të kryerjes së obligimeve të përcaktuara me dispozitat e vlefshme, përpunohen dhe ruhen në masën në të cilën kjo është e domosdoshme për përpunimin e llogarisë dhe në periudhën derisa të skadojë afati i përcaktuar me ligj për paraqitjen e kundërshtimit nga ana e shfrytëzuesit dhe derisa të skadojë afati për arkëtimin e kërkesave.

4. Parapaguesi me lidhjen e Kontratës e pranon që, në rast se përmes rrjetit të mts i përdor shërbimet me vlerën e shtuar të personave të tretë – operatorit të shërbimeve të theksuara, të dhënat nga pikat 2 dhe 3 të këtij neni, mund t'u dërgohen operatorëve të shërbimeve me vlerën e shtuar shërbimet e të cilëve i ka përdorur, dhe këtë të dhënat nga pika 2 me qëllim të arkëtimin të kërkesës nga ana e operatorëve të theksuar, kurse të dhënat nga pika 3, me qëllim të arkëtimin të kërkesave dhe zgjidhjes së kundërshtimeve nga ana e këtyre operatorëve.

5. Parapaguesi me lidhjen e Kontratës e pranon që mts do t'i mbajë të dhënat e tij në numërorin e vet publik telefonik që e ka (elektronik dhe të shtypur). Mts nuk ka për detyrë që të verifikojë saktësinë e të dhënave të cilat i ka dhënë parapaguesi në numëror telefonik. Parapaguesi ka të drejtë që mts-së, pa pasur obligim të paguajë kompensim, t'ia anulojë pëlqimin e dhënë më parë përkatësisht të kërkojë shlyerjen e të dhënave të veta nga numërori telefonik.

6. Parapaguesi do ta njoftojë mts-në për secilin ndryshim të dhënave të veta të cilat janë të nevojshme për aplikimin e Kontratës pa shtyrje pasiqë vjen deri te ndryshimi. Nëse këtë nuk e bën, do të përgjigjet për secilin dëm i cili i krijohet mts-së për shkak të kësaj ose personave të tretë. Nëse për këtë shkak llogaritë, vërejtjet për shkak të mospagimit dhe dokumentet e tjera të mts-së nuk mund të dërgohen, do të konsiderohet se në bazë të dhënave ekzistuese dërgimi është bërë siç duhet.

7. Me ndryshimin e të dhënave të parapaguesit konsiderohet edhe ndryshimi i emrit dhe mbiemrit të personit fizik, ose ndryshimi i emrit menaxhues i shoqërisë ekonomike, si edhe rasti i ndryshimeve statusore të shoqërisë ekonomike të bëra në pajtim me dispozitat e vlefshme.

8. Me rastin e krijimit të thirrjes numri i thirrës, transferohet përmes rrjetit, me përjashtim nëse thirrësit me kërkesën e tij i është parandaluar identifikimi i linjës thirrëse. Identifikimi i numrit thirrës patjetër pasqyrohet në rastet e thirrjes së shërbimit për ndërhyrje urgjente, ose shërbimit të mts-së për paraqitjen e pengesave, reklamimeve, paraqitjes së kërkesës për shërbim dhe kontrollit të rrjetit.

6.Kompensimet, çmimet dhe llogaria

1. Çmimet të cilat mts i aplikon për shërbimet e telefonisë celulare janë përkufizuar me Listën e çmimeve.

2. Listën e çmimeve e kanë Shfrytëzuesit e shërbimeve në të gjitha vendet e shitjes së mts-së, në internet dhe të distributorëve të autorizuar, por gjithashtu edhe në faqen zyrtare në Internet të mts-së.

3. Mts mundet të krijojë shërbime të reja, t'i ndryshojë ose t'i suprimojë disa shërbime nga oferta ekzistuese e mts-së, përkatësisht paketës së tarifës dhe modelet siç edhe disa shërbime celulare dhe kushtet për përdorimin e tyre bashkë me njoftimin paraprak të Shfrytëzuesit të shërbimeve, në çdo gjë sipas dispozitave në fuqi, përmes mjeteve të informimit publik ose në ndonjë mënyrë tjetër përkatëse (faqja zyrtare në internet, SMS, posta elektronike, llogaria dhe të ngjashme).

4. Mts-ja Parapaguesit për çdo muaj do t'ia dërgojë llogarinë për shërbime e ofruara celulare të mts-së. Shpenzimet e transferimit të pagesave të cilat mund të krijohen lidhur me pagimin e llogarisë plotësisht i mban Parapaguesi. Parapaguesi ka për detyrë që të paguajë shumën e përgjithshme të borxhit të krijuar gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, duke përfshirë edhe shpenzimet e romingut, llogaria e të cilit mund të vonohet dhe mund të përlllogaritet në një llogari të veçantë.

5. Mts llogarinë e dërgon në adresë të Parapaguesit, përveç nëse parapaguesi e ka kërkuar dërgimin në ndonjë mënyrë tjetër, por gjendet edhe në formën elektronike për të gjithë parapaguesit përmes faqes zyrtare në Internet të mts-së e theksuar në nenin 1 të Kushteve të përgjithshme, email-it, Qendrës për kontakte, zyre ose në vende të autorizuar të shitjes së mts-së. Nëse parapaguesit nuk i dërgohet llogaria në emër të shërbimeve të ofruara celulare të mts-së, parapaguesi deri në ditën e skadimit të afatit për pagimin e llogarisë për këtë e njofton mts, duke shkuar në zyre, me shkrim, duke dërguar imejl, ose duke e thirrur qendrën për kontakte që t'i dërgohet llogaria përkatësisht informata për shumën e llogarisë. Mts e ruan të drejtën që ta ndryshojë kohën e lëshimit të llogarisë, për çfarë me kohë do t'i njoftojë parapaguesit në mënyrë adekuate.

6. Me kërkesën e parapaguesit, do t'i dërgohet specifikimi i detajuar i të gjitha shërbimeve të cilat arkëtohen në llogari të veçantë të ngarkimit për secilin shërbim individual. Kjo që u theksua shfrytëzuesit do t'ia mundësojë periudhën brenda së cilës do të mund të paraqesë kundërshtim për shumën e llogarisë.

7. Mts ka të drejtë ta ndryshojë Listën e çmimeve, Kushtet e përgjithshme si edhe kushtet komerciale dhe/ose kushtet e dhënies së shërbimeve. Informatat për ndryshime do t'ua bëjë të disponueshme Shfrytëzuesve të shërbimeve në pajtim me ligjin në fuqi dhe me dispozitat jo më pak se 30 ditë para ndryshimit të çmimit përkatësisht kushteve të dhënies së shërbimeve.

8. Mts për ndryshimet e veta do t'i njoftojë Shfrytëzuesit e shërbimeve në faqen e vet zyrtare në internet www.mts.rs, në zyrat dhe në vendet e tjera të shitjes së mts-së, dhe këtë në pajtim me dispozitat e vlefshme.

9. Në rast të ndryshimit të çmimit të kushteve të kontraktuara të dhënies së shërbimeve dhe Kushteve të përgjithshme vetëm në favor të Shfrytëzuesit të shërbimeve, të njëjtat mund të aplikohen në ditën e publikimit.

10. Nëse me ndryshimet e theksuara dukshëm ndryshohen kushtet nën të cilat është lidhur Kontrata, parapaguesi do të njoftohet, jo më pak se 30 ditë më parë, me shkrim ose përmes llogarisë për dhënien e shërbimeve, me anë të SMS-së, e-mailit ose në ndonjë mënyrë tjetër e cila është harmonizuar më parë me parapaguesin. Parapaguesi ndaj të cilit aplikohen ndryshimet e theksuara mund ta anulojë Kontratën

në periudhën derisa të hyjnë në fuqi kushtet e ndryshuara ose çmimet. Nëse këtë nuk e bënë brenda afatit të theksuar do të konsiderohet se i ka pranuar ndryshimet e theksuara.

11. Ndryshimet dhe plotësimet e Kushteve të përgjithshme të cilat e përfaqësojnë harmonizimin me dispozitat ligjore në fuqi nuk konsiderohen ndryshim i kushteve, nën të cilat është lidhur Kontrata, në dëm të parapaguesit.

7. Arkëtimi i kërkesave

1. Parapaguesi ka për detyrë të paguajë tërë shumën e përlogaritur të llogarisë deri në ditën e maturimit e theksuar në llogari të mts-së.

2. Shfrytëzuesve u është mundësuar pagimi i llogarisë te të gjitha institucionet e regjistruara për transferim të pagesave. Parapaguesi mund të paguajë llogarinë edhe me llogari të përhershme te bankat të cilat ofrojnë shërbime për sanksione të theksuara të pagesave. Kompensimin për transaksionin e kryer të pagesave e mban Parapaguesi në pajtim me Listën e çmimeve dhe me kushtet e dhënësit të shërbimit të transferimit të pagesave.

3. Mts nuk mban përgjegjësi nëse pagesa nuk ka mundur të evidentohet për shkak se parapaguesi ka dhënë të dhëna të pasakta dhe/ose jo të plota, që nuk e ka shkruar siç duhet në formularin për pagesa numrin e llogarisë dhe/ose të dhënat e tjera të domosdoshme për evidentimin e rregullt të pagesës ose që pagesa nuk është evidentuar për shkak të gabimit të organizatës për kryerjen e transferimit të pagesave, si edhe në rastin kur ka filluar masa e ndërprerjes së shërbimeve dhe paraqitja e padisë kundër parapaguesit për shkak se nuk e ka bërë pagesën për të cilën ka qenë i detyruar ta bëjë. Një pagesë e tillë do të evidentohet vetëm atëherë kur mjetet të paguhen në llogari të mts-së ose nëse Parapaguesi ofron dëshmi se e ka bërë pagesën. Në rast se janë paguar më shumë të holla se sa shuma në llogari, mts do ta zvogëlojë shumën për pagimin e llogarisë në periudhën e ardhshme, ose do ta kthejë tepricën e shumës së paguar me kërkesën e Parapaguesit. Parapaguesi mban përgjegjësi për të gjitha shpenzimet të cilat mund të krijohen lidhur me pagimin e llogarisë, si edhe të gjitha shpenzimet e kthimit të të hollave të paguara tepricë nëse kjo është bërë për shkak të gabimit të mts-së.

4. Parapaguesi ka për detyrë që ta paguajë kamatën ligjore për vonesë për shkak të tejkalimit të afatit të pagimit të llogarisë, e cila llogaritet deri në ditën e pagimit të mjeteve në xhirollogari të mts-së.

5. Në rast se parapaguesi nuk e kryen obligimin e pagesës pas skadimit të afatit të maturimit të llogarisë, Mts me shkrim ose në formë elektronike (SMS) do ta njoftojë për obligimet e pakryea dhe do ta ftojë që t'i kryejë të njëjtat brenda afatit prej 8 ditësh, që t'i shmanget masës së ndërprerjes së përkohshme të dhënies së shërbimeve.

6. Nëse Parapaguesi nuk e kryen obligimin e pagesës brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e maturimit të obligimit, me kusht që të ketë kaluar edhe afati prej jo më pak se 8 ditësh nga dërgimi i vërejtjes për shkak të moskryerjes së pagesës, mts ka të drejtë që Parapaguesit përkohësisht t'ia ndalë dhënien e shërbimeve të cilat i ofron sipas

Kontratës sipas së cilës Parapaguesi nuk po i kryen obligimet e veta kontraktuese. Gjatë masës së ndërprerjes së përkohshme të pjesërishtme të qarkullimit shfrytëzuesit i mbetet mundësia që t'i vijë thirrjet përveç romingut, si edhe linjat thirrëse në drejtim të shërbimeve për ndërhyrje urgjente.

7. Në rast se parapaguesi nuk e shlyen obligimin e pagesës derisa të skadojë afati prej 45 ditësh i kohëzgjatjes së kufizimit të shërbimeve të thirrjeve sipas mënyrës së theksuar (60 ditë nga dita e maturimit të obligimit të pagimit), mts ka të drejtë që Parapaguesit t'ia ndërprejë edhe shërbimet e thirrjes në tërësi. Shërbimet do t'i kthehen përsëri Parapaguesit në ditën e shlyerjes së obligimit, e jo më vonë se 2 ditë pune pas shlyerjes së borxhit.

8. Për rivendosjen e shërbimeve që kanë qenë objekt i ndërprerjes së përkohshme, dhe këtë pasiqë parapaguesi i shlyen të gjitha obligimet e maturuara për shërbimet e theksuara, parapaguesi e paguan kompensimin për rikthimin e shërbimeve i përcaktuar me Listën e çmimeve.

9. Nëse Parapaguesi nuk e paguan llogarinë as pas 75 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë për pagesë, me të cilin rast ka kaluar afati prej jo më pak se 8 ditësh nga vërejtja para ndërprerjes së përhershme, mts ka të drejtë që parapaguesit t'ia ndërprejë dhënien e shërbimit përgjithmonë dhe ta anulojë Kontratën, kurse për kërkesat e mbetura ta fillojë procedurën e arkëtimit përmes gjykatës.

10. Mts është i autorizuar që t'ua kalojë të drejtat e kërkesave të cilat i ka ndaj Parapaguesit personave të tretë, bankave dhe agjencive për arkëtim të kërkesave, sipas mënyrës dhe në pajtim me dispozitat e vlefshme, me të cilin rast Parapaguesi i shërbimeve nuk mban përgjegjësi për shpenzimet e kalimit të të drejtave as kurrfarë shpenzimesh të tjera që do të mund të krijoheshin nga kalimi i të drejtave të kërkesave.

11. Nëse për shkak të aftësisë paguese të shfrytëzuesit, që ai t'i kryejë obligimet e pagimit në periudhën e mëparshme, përdorimit mesatar të shërbimeve, shumës së borxhit të përgjithshëm, mts objektivisht vlerëson se Parapaguesi nuk do t'u përmbahet obligimeve të kontraktuara të pagesës, ose që kërkesat vështirë do të arkëtohen, Mts mund të kërkojë nga parapaguesi që të deponojë një shumë të caktuar të mjeteve që të sigurojë pagesën e cila është e pranueshme për mts. Nëse Parapaguesi nuk e bën këtë, Mts ka të drejtë që të ndërmarrë masa të ndërprerjes së përkohshme të dhënies së shërbimeve, të theksuar në pikën 11. Mts ka të drejtë të shlyejë tërë kërkesat ndaj Parapaguesit nga mjetet e deponuara me të cilat e ka siguruar pagesën.

8. Obligimet dhe përgjegjësia e mts-së

1. Mts obligohet se Shfrytëzuesve të shërbimeve t'ua ofrojë shërbimet e kontraktuara celulare të Mts-së në pajtim me parametrat e përkufizuar të cilësisë të cilat i përcakton Autoriteti Rregullator për shërbime elektronike dhe postare (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti).

2. Mts e siguron punën e rregullt dhe të papenguar të rrjetit celular, rregullisht i mirëmban kapacitetet e veta të rrjetit dhe e bën mbikëqyrjen e funksionimit dhe të

cilësisë së shërbimeve në pajtim me standardet teknike dhe dispozitat. Shfrytëzuesi i shërbimeve celulare e pranon që në kuadër të mundësive teknike dhe operative të rrjetit publik celular të Mts-së ekziston mundësia që shërbimet celulare nuk do të jenë në disponim në çdo moment dhe në çdo vend. Mts e ruan të drejtën që për shkak të punimeve në rrjet pjesërisht ose tërësisht kohëpaskohe ta ndërprejë dhënien e shërbimeve.

3. Paraqitjen për mosfunksionimin e shërbimit, përkatësisht pengesave, Shfrytëzuesi i shërbimeve e bën duke e thirrur Qendrën për kontakte, përmes web portalit, përmes postës elektronike ose me shkrim në adresën nga llogaria.

4. Nëse për shkak të pengesës teknike më të gjatë se 48 orë dhe/ose për shkak të cilësisë së zvogëluar, sipas parametrave të përkufizuar të Autoritetit, shërbimi nuk ka qenë në disponim për shkaqe të cilat gjenden në anën e mts-së, Parapaguesi e realizon të drejtën për zvogëlimin e kompensimit mujor për shërbimin në përpjesëtim me numrin e ditëve sa kanë zgjatur pengesa, përveç nëse me Kontratë nuk është rregulluar më ndryshe.

5. Mts, në kufijtë e lejuar me ligj, mban përgjegjësi për dëmin real të krijuar si pasojë e drejtpërdrejtë e personave të autorizuar të mts-së dhe nuk mban përgjegjësi për fitimin e humbur as për dëmin indirekt ose si pasojë.

6. Mts nuk ka për detyrë të kryejë kompensimin e dëmit nëse niveli i cilësisë së shërbimit të ofruar celular është më i vogël nga ai i përcaktuar për shkaqe objektive të cilat nuk kanë mundur të parashikohen ose të shmangen ose të mënjanoen (fuqia mdhore) gjë që i përfshin edhe pengesat jashtë sistemit të rrjetit celular mts-së. Gjithashtu, mts nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmin eventual i krijuar gjatë kohës së mirëmbajtjes së rrjetit publik celular të mts-së, dhe i cili do të mund të ndikonte në cilësinë e shërbimeve të ofruara celulare si edhe për dëmin ose përfitimin e humbur të Shfrytëzuesit të shërbimeve i krijuar për shkak të pengesave gjatë përdorimit të shërbimeve, përveç nëse me dispozia ligjore nuk është caktuar më ndryshe.

7. Mts nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e komunikimit përmes rrjetit celular, gjë që është në fushën e Shfrytëzuesit të shërbimeve përkatësisht të pjesëmarrësve të tjerë të komunikimit.

8. Mts e ruan të drejtën, që kur e zbaton politikën e menaxhimit me rrezik, kohëpaskohe ta ndërprejë përdorimin e shërbimeve të caktuara si edhe zbatimin e masave të tjera përkatëse me qëllim të mbrojtjes nga keqpërdorimet, mashtrimet dhe kufizimet e shpenzimeve, dhe këtë për mbrojtjen e interesave të Shfrytëzuesit të shërbimeve dhe mts-së.

9. Rregullat e sjelljes në rrjet

1. Shfrytëzuesi i shërbimeve celulare ka për detyrë që të përdorë pajisjen e rregullt terminale e cila në vështrim të këtyre Kushteve të përgjithshme e përfaqëson celularin, aparatit ose aparatet të cilat Shfrytëzuesit e shërbimeve ia mundësojnë përdorimin e shërbimeve të mts-së në rrjetin celular, dhe puna e të cilëve është në pajtim me dispozitat e vlefshme.

2. Shfrytëzuesi i shërbimeve ka për detyrë që të mirëmbajë pajisjen e vet terminale në gjendje të rregullt, kështu që me rastin e përdorimit të mos e prishë cilësinë e shërbimeve celulare të mts-së, siç as sigurinë dhe integritetin e rrjetit celular të mts-së. Mts e ruan të drejtën që të bëjë kontrollin e drejtpërdrejtë të rregullsisë së pajisjes terminale të Shfrytëzuesit të shërbimeve që nuk është telefon lëvizës në rast se dyshon në rregullsinë e saj.

3. Shërbimet celulare të mts-së duhet të përdoren vetëm në mënyrë ligjore dhe në pajtim me destinimin e përcaktuar me Kontratë dhe me Kushte të përgjithshme.

4. Shfrytëzuesi i shërbimeve ka për detyrë që të mos e rrezikojë punën dhe të mos i shkaktojë dëm funksionimit të rrjetit celular, të mos i shqetësojë shfrytëzuesit e tjerë dhe të mos e përdorë shërbimin përkatësisht të mos ua mundësojë personave të tretë që ta përdorin shërbimin sipas mënyrës e cila mund të shkaktojë pengesa shfrytëzuesve të tjerë ose për përdorimin e paautorizuar të informacioneve të huaja ose burimeve për kryerjen e veprimeve ilegale.

- bypass i trafikut ndërkombëtar
- dërgimi i mesazheve njërin pas tjetrit
- zbulimi jo i autorizuar i të dhënave për personalitetin
- shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale
- dërgimi, marrja dhe/magazinimi i çfarëdo të dhënash të cilat mund t'i shkaktojnë dëm të çfarëdo lloji mts-së dhe/ose shfrytëzuesve të saj, të cilët diskriminojnë, ofendojnë përkatësisht përmbajnë përmbajtje jomorale, kërcënuese, mashtruese dhe përmbajtje të tjera të padëshirueshme.
- distribuimin e mesazheve SMS, MMS, përmes emailit dhe/ose përmbajtjes tjetër kumtimi i së cilës përkatësisht distribuimi publik është i ndaluar me ligj.
- dërgimi i një sasive të madhe të mesazheve të padëshirueshme ose jo të kërkuara shfrytëzuesve të tjerë, si edhe publikimi dhe bartja e materialeve promovuese dhe reklamuese për shfrytëzuesit e tjerë pa kërkesën ose pëlqimin e tyre.

5. Shfrytëzuesi i shërbimeve ka për detyrë që t'i përmbahet secilit udhëzimi dhe njoftimit të Mts-së që ka të bëjë me përdorimin e rregullt të shërbimit të kontraktuar.

6. Mts ka të drejtë të incizojë thirrjet e Shfrytëzuesit të dërguara në qendrën për kontakte mts-së, për çfarë Shfrytëzuesi i shërbimeve do të njoftohet para vendosjes së lidhjes me të punësuarin në Qendrën për kontakte.

7. Shfrytëzuesi i shërbimeve mban përgjegjësi për përdorimin e shërbimeve të rrjetit celular, me të cilin rast për çdo gjë do t'u përmbahet Kushteve të përgjithshme. Shfrytëzuesi i shërbimeve ka vetëm të drejtë të përdorimit të shërbimeve, pa pasur mundësi t'ua mundësojë personave jo të autorizuar përdorimin e çfarëdo burimeve të rrjetit elektronik të komunikimit të mts-së, që mbetet vetëm në pronësi të mts-së.

8. Parapaguesi mban përgjegjësi për përmbajtjen e mesazhit të cilin e bart përmes Rrjetit, ose përmbajtjen e të cilit mund ta shohin personat e tretë. Mts nuk mban

përgjegjësi për përmbajtjen e mesazheve të theksuara, për mesazhe të cilat i pranon Parapaguesi, as për përmbajtjen e çfarëdo mesazheve të cilat i përhap personi i tretë ose i bën transparente përmes rrjetit. Në rast të përdorimit të shërbimeve për trajtim jo të autorizuar me informata ose burime të huaja përkatësisht për kryerjen e çfarëdo veprimesh ilegale, duke përfshirë edhe shkeljen e të drejtave të pronës intelektuale, ose për mundësimin e çfarëdo nga kjo që u theksua personit të tretë, Parapaguesi do të ketë për detyrë që ta rimarrë tërë përgjegjësinë, dhe që mts-së t'ia kompensojë tërë dëmin e pësuar për shkak të një veprimi të tillë, duke përfshirë edhe shpenzimet e zhvillimit të kontestit.

9. Nëse Shfrytëzuesi i shërbimeve i përdor shërbimet e mts-së për blerjen e mallit ose shërbimeve nga personat e tretë ose për nevojat e përdorimit të shërbimeve të personit të tretë përmes Rrjetit të mts-së, përgjegjësinë për shërbime ose mall të blerë ose të porositur sipas mënyrës së theksuar e mban personi i tretë i cili është dhënë i shërbimit përkatësisht shitës i mallit.

10. Kundërshtimet e Shfrytëzuesve të shërbimeve

1. Parapaguesi mund të paraqesë kundërshtim në përlogari ose llogari për shërbime të ofruara të komunikimit, për cilësi përkatësisht funksionimin e shërbimeve si edhe kundërshtimet e tjera të cilat mund të kenë të bëjnë me statusin e shërbimit, marrëdhënies kontraktuese ose përkrahjen e shfrytëzuesit.

2. Shfrytëzuesit privatë (personat fizikë) mund të bëjnë kundërshtim me gojë ose me shkrim. Shfrytëzuesit menaxhues (personat juridikë) kundërshtimet, përveç kundërshtimit për funksionim, i paraqesin me shkrim.

3. Kundërshtimet mund të dërgohen në adresën e theksuar në pikën 14, si adresë për komunikim me shfrytëzuesin e shërbimeve dhe të njëjtat mund të deklarohen përmes Qendrës për kontakte, emailit, faqes zyrtare në internet, në zyra të mts-së përkatësisht në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar me dispozitat e vlefshme. Gjithashtu, kundërshtimet me shkrim mund të dërgohen në adresë të kompanisë:

MTS SH.P.K

Oslobogjenja 1

Mitrovica e Kosovës

Parapaguesit me kohë do të njoftohen për secilin ndryshim të adresës në të cilën mund të dërgohen kundërshtimet.

4. Parapaguesi i shërbimeve ka të drejtë të paraqesë kundërshtim lidhur me cilësinë ose funksionimin e shërbimit brenda afatit prej 30 ditësh nga data e dhënies së shërbimit përkatësisht brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e maturimit për arkëtimin e llogarisë për shërbim kur bëhet fjalë për kundërshtim ndaj përlogaritjes ose për shumën e llogarisë për shërbimin e dhënë. Pas skadimit të afateve të theksuara, konsiderohet se Parapaguesi plotësisht është dakord me kushtet, mënyrën e realizimit dhe llogarinë e dhënë për shërbime të ofruara.

5. Parapaguesi i cili bën kundërshtimin nga paragrafi 1, i këtij neni ndaj shumës me të cilën është i ngarkuar për shërbimin e dhënë, deri te zgjidhja e kundërshtimit e paguan pjesën jokontestuese të shumës së llogarisë për dhënien e shërbimit ose shuma mesatare me të cilën ka qenë i ngarkuar në periudhën prej jo më shumë se tre muajve para periudhës për të cilën ka të bëjë kundërshtimi. Në rast të mosshlyerjes së pjesës jokontestuese të shumës së llogarisë për shërbimin e dhënë ose shumës mesatare me të cilën shfrytëzuesi i fundit ka qenë i ngarkuar për periudhën prej jo më shumë se tre muaj para periudhës me të cilën ka të bëjë kundërshtimi, mts ka të drejtë t'i zbatojë masat në pajtim me nenin 11 të Kushteve të përgjithshme.

6. Për shërbimet e operatorit të shërbimeve me vlerën e shtuar të cilët këto shërbime i ofrojnë përmes rrjetit të mts-së përgjigjen operatorët e shërbimeve me vlerën e shtuar dhe kundërshtimet për shumën e ngarkimit dhe për cilësinë e shërbimit me vlerën e shtuar u dërgohen operatorëve të theksuar për zgjidhje.

7. Afati për zgjidhjen e kundërshtimeve është 15 ditë (nëse dita e 15-të bie të dielen ose në ndonjë ditë pushimi, afati shtyhet për ditën e parë të punës nga dita e marrjes së kundërshtimit).

8. Në rast se konstatohet se kundërshtimi ndaj llogarisë është i bazuar, Shfrytëzuesit të shërbimeve do t'i zvogëlohet llogaria për shumën e faturuar më shumë, e nëse llogaria është paguar kjo shumë do t'i ndahet si akontacion për llogarinë e ardhshme ose do t'i kthehet shfrytëzuesit nëse ai këtë e kërkon, kurse shfrytëzuesit pripejd do t'i shtohet kredia për këtë shumë.

9. Nëse Shfrytëzuesi i shërbimeve nuk është i kënaqur me zgjidhjen e kundërshtimit, mundet, përveç të drejtave të tjera të cilat i ka në pajtim me Ligjin, brenda afatit prej 15 ditësh pas marrjes së përgjigjes nga mts, përkatësisht nga skadimi i afatit për dërgimin e përgjigjes, t'i drejtohet Autoritetit për ndërmjetësim në zgjidhjen e kontestit jashtë gjykatës ose ta fillojë procedurën kontestimore para gjykatës kompetente.

11. Ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve

1. Mts ka të drejtë që në rastet kur Shfrytëzuesi i shërbimeve nuk i respekton të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me këto Kushte të përgjithshme përkohësisht ta ndërprejë dhënien e shërbimeve, duke i njoftuar paraprakisht Parapaguesit, përveç në rastin e keqpërdorimeve të rënda ose të përsëritura, kur Parapaguesin mund ta ndërprejë edhe pa njoftim të mëparshëm.

2. Mts nuk ka për detyrë ta kompensojë dëmin eventual i krijuar për shkak të ndaljes së përkohshme të dhënies së shërbimeve, përveç nëse në nenin 15 të Kushteve të përgjithshme nuk është përcaktuar shprehimisht më ndryshe.

3. Ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve të mts-së mund të kryhet për shkaqe të përkufizuara me akte ligjore dhe nënligjore nga fusha e komunikimeve elektronike dhe dispozitave të tjera të vlefshme, si edhe për këto arsye:

- nëse konstatohet se Parapaguesi ka dhënë të dhëna të rreme që janë parakusht për lidhjen e Kontratës;

- nëse shfrytëzuesi brenda afatit prej 15 ditësh nga data e krijimit të ndryshimit të të dhënave që janë parakusht për lidhjen e Kontratës nuk ia dërgon mts-së të dhënat e reja;
- nëse mts më vonë konstaton se kanë ekzistuar çfarëdo shkaqesh për refuzimin e kërkesës në Kushtet e përgjithshme;
- nëse Shfrytëzuesi e prish sigurinë e punës dhe tërësinë e rrjetit celular të mts-së, si edhe e mundësinë e funksionimit të shërbimeve elektronike të komunikimit dhe mbrojtjen e të dhënave përkatësisht nëse nuk i respekton rregullat e sjelljes në rrjetin nga pika 9.4.;
- nëse shfrytëzuesi nuk e paguan llogarinë as pas 15 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë së dërguar nga ana e Mts-së për pagesë, me të cilin rast nga vërejtja gjithashtu kanë kaluar jo më pak se 8 ditë, por që, kur bëhet fjalë për shërbimet e thirrjes, shërbimet ndërpriten pjesërisht, e jo në tërësi, domethënë kufizohen, ashtu që edhe më tutje zhvillohet trafiku i linjës së thirrur pa roming dhe thirrja e shërbimeve për ndërhyrje urgjente;
- nëse parapaguesi të cilit, për shkaqet të theksuara në alinenë e mëparshme, shërbimet e thirrjes i janë kufizuar, ashtu që trafiku i linjës thirrëse dhe thirrja e shërbimeve për ndërhyrje urgjente i është mundësuar gjatë periudhës prej 45 ditësh nga ndërprerja e përkohshme e pjesërishtme (kufizimi) i shërbimeve, obligimin e vet të pagimit nuk e shlyen derisa të kalojë periudha e theksuar, në të cilin rast shërbimet mund t'i ndërpriten përkohësisht në tërësi me kusht të ketë kaluar afati prej jo më pak se 30 ditësh nga vërejtja adekuate;
- nëse shfrytëzuesi nuk ofron mjete që e sigurojnë pagesën (depozitën e të ngjshme) në pajtim me pikën 7.10 të Kushteve të përgjithshme ose nuk paguan avans.;
- në bazë të Vendimit juridik të organit kompetent shtetëror.

4. Mts menjëherë do ta kyçë kartelën SIM të Shfrytëzuesit të shërbimeve pas dhënies së dëshmimeve se kanë pushuar shkaqet për ndërprerjen e përkohshme, përkatësisht në momentin kur konstaton se kanë pushuar shkaqet për ndërprerjen e përkohshme. Nëse shkaqet për ndërprerje të përkohshme nuk pushojnë në pajtim me afate të përcaktuara me këto Kushte të përgjithshme, mts e ruan të drejtën ta anulojë Kontratën, përkatësisht ta ç'aktivizojë kartelën SIM.

5. Gjatë kohës së ndërprerjes së përkohshme nga rrjeti përkatësisht ndaljes së dhënies së shërbimeve për të cilën gjë shkak është faji i shfrytëzuesit, parapaguesi ka për detyrë të vazhdojë të paguajë kompensimin mujor për tërë periudhën sa është e vlefshme Kontrata për ndërprerjen e shërbimit. Shkaqet e theksuara për ndërprerjen e përkohshme, përkatësisht ndërprerjen e dhënies së shërbimeve, aplikohen pa e marrë parasysh faktin a i ka shkaktuar parapaguesi ose ndonjë person i tretë të cilit i është mundësuar kjo përmes shërbimit të cilën e ka kontraktuar parapaguesi, dhe pavarësisht nga kjo a ka vepruar personi i tretë me dijeni ose pa dijeni të parapaguesit.

6. Parapaguesi ka për detyrë ta paguajë kompensimin sipas Listës së çmimeve në emër të shpenzimeve për riaktivizimin e shërbimit të ndërprerë, që faturohet pasiqë ka pushuar shkakun për ndërprerjen e përkohshme të shërbimit dhe pasiqë është riaktivizuar shërbimi.

7. Mts me qëllim të mbrojtjes së interesit të parapaguesit dhe për interes të vet si dhënësi i shërbimit celular, e ruan të drejtën e kontrollit të konsumit dhe përdorimit të shërbimeve.

8. Mts e ruan të drejtën që ta përcaktojë shumën e kontrollit ditor, javor dhe mujor të konsumit, domethënë limitin ditor, javor dhe mujor, si edhe t'i konstatojë rastet në të cilat shfrytëzuesi bën tejkalime të të drejtave të veta në përdorimin e shërbimeve nga kontrata e lidhur. Mts në mënyrë adekuate (me thirrje telefonike ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme) e njofton shfrytëzuesin për tejkalimin e harxhimit, përkatësisht për tejkalimin e të drejtave në shfrytëzimin e shërbimeve, si edhe për obligimet të cilat lidhur me këtë rast vendosen për shfrytëzuesin. Nëse shfrytëzuesi i tejkalon shumat e theksuara të konsumit, e që nuk e ka siguruar avansin e mjeteve për harxhimin e theksuar, do të realizohet ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimit në fjalë derisa të kryejë obligimet e krijuara.

12. Kohëzgjatja dhe pushimi i vlefshmërisë së Kontratës

1. Ndërprerja/anulimi i kontratës dhe pushimi i dhënies së shërbimeve mund të bëhet sipas kërkesës së Parapaguesit ose sipas kërkesës së mts-së, për shkak të mosrespektimit të neneve të Kontratës ose të Kushteve të përgjithshme, si edhe në bazë të Vendimit të gjykatës kompetente, Vendimit të Autoritetit dhe ligjeve në fuqi.

2. Mts mund ta ndërprejë kontratën njëanshëm dhe përgjithmonë ta ndërprejë dhënien e shërbimit ose shërbimeve, në këto raste:

- nëse adresa e parapaguesit për dërgimin e llogarisë dhe njoftimit të mts-së është e panjohur edhe pas përpjekjes së dytë të dorëzimit;
- nëse kundër parapaguesit ka filluar procedura falimentuese ose likuiduese, dhe për këtë janë plotësuar kushtet sipas dispozitave të vlefshme;
- për shkak të vdekjes së parapaguesit;
- në të gjitha rastet në të cilat nuk është respektuar afati ose aktivitetet për shkak të të cilave është krijuar ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve, pas skadimit të afatit të dhënë;
- nëse parapaguesi nuk i shlyen borxhet e veta të arritura as pas 75 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë së dërguar nga ana mts-së që ta bëjë pagesën, me kusht që të ketë kaluar afati prej jo më pak se 8 ditë nga vërejtja para ndërprerjes së përhershme të dhënies së atij shërbimi ose shërbimeve;
- në të gjitha rastet e përcaktuara me ligj dhe me dispozita të vlefshme;
- nëse mts e humb autorizimin e nevojshëm për dhënien e shërbimeve të kontraktuara në rrjetin celular.

1.Parapaguesi mund ta anulojë Kontratën duke e njoftuar mts-së me shkrim ose duke shkuar në zyra dhe duke e nënshkruar kërkesën për anulimin e Kontratës. Kërkesa për anulim të Kontratës dhe ndërprerjen e shërbimit duhet t'i dërgohet Mts-së jo më

pak se 30 ditë para datës së kërkuar që kur kërkohet që shërbimi të ndërpritet përgjithmonë, por që parapaguesi edhe më tutje është i obliguar t'ia paguajë Mts-së kompensimet dhe trafikun e realizuar për përdorimin e shërbimeve në periudhën derisa të pushojë vlefshmëria e Kontratës.

4. Në rastin para skadimit të periudhës së kohëzgjatjes së obliguar të Kontratës parapaguesi e anulon Kontratën ose mts-së me fajin e Parapaguesit e anulon Kontratën, parapaguesi ka për detyrë ta paguajë edhe kompensimin e dëmit sipas bazës së anulimit të parakohshëm të Kontratës.

5. Nëse vdes parapaguesi pasardhësit e tij ose anëtarët e familjes, kanë për detyrë që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e vdekjes së parapaguesit me shkrim ta njoftojnë Mts-në për të njëjtin. Pasardhësit ose anëtarët e familjes së parapaguesit që ka vdekur mund të kërkojnë transferimin e kontratës parapaguese në pajtim me Kushtet e përgjithshme. Pasardhësit e parapaguesit të vdekur përgjigjen për të gjitha kërkesat e krijuara deri në ditën kur Mts është njoftuar me shkrim për vdekjen e parapaguesit, në pajtim me dispozitat e vlefshme.

6. Parapaguesi kundër të cilit ka filluar procedura falimentuese ose likuiduese, ka për detyrë që me shkrim, ta njoftojë Mts-në se e ka filluar një procedurë të tillë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e fillimit të saj. Parapaguesi kundër të cilit ka filluar procedura falimentuese ose likuiduese ka për detyrë që t'ia paguajë të gjitha kërkesat Mts-së, të cilat janë krijuar deri në ditën e anulimit të Kontratës.

7. Mts ka të drejtë, në rastet kur parapaguesi nuk i respekton obligimet nga marrëdhënia kontraktuese, që njëanshëm ta anulojë Kontratën përkatësisht t'ai ndërprejë dhënien e një, disa ose të gjitha shërbimet, duke e njoftuar më parë. Në rastet kur për kontroll të përmbajtjes së palejuar ose keqpërdorimit tjetër, në pajtim me ligjin, është autorizuar organi kompetent, masat e ndërprerjes së përhershme të shërbimeve mund të ndërmerren pas përcaktimit të një keqpërdorimi të tillë nga ana e organit kompetent.

8. Mts nuk ka për detyrë që të japë arsyetim dhe/ose ta kompensojë dëmin eventuale të krijuar për shkak se e ka ndërprerë dhënien e shërbimeve përgjithmonë, përveç nëse me Kontratë dhe me Kushte të përgjithshme nuk është përcaktuar më ndryshe.

9. Shkaqet për anulimin e Kontratës përkatësisht për ndërprerjen e përhershme të dhënies së shërbimeve, janë mbizotëruese pa e marrë parasysh kush i ka shkaktuar, parapaguesi ose ndonjë person i tretë, me dijeni ose pa dijeni të Parapaguesit.

10. Pasojat juridike të ndërprerjes së vlefshmërisë së Kontratës krijohen ditën kur mts e ka bërë ndërprerjen e përhershme, për çfarë parapaguesi do të njihet në mënyrë adekuate.

13. Kalimi i të drejtave të Kontratës dhe pasardhësia juridike

1. Kontrata mund të bartet në ndonjë person tjetër juridik ose fizik, me kusht që parapaguesi i ri të vazhdojë t'i përdorë shërbimet celulare të mts-së, me të njëjtin kartelë SIM dhe me numerimin e lidhjes. Kusht për transferim është që të jenë kryer

të gjitha obligimet sipas bazës së përdorimit të shërbimeve për të cilat është lidhur kontrata.

2. Të drejtat dhe obligimet sipas Kontratës mund të barten vetëm me pajtimin paraprak me shkrim të mts-së dhe duke i pakuar kompensimet e përcaktuara me Listën e çmimeve.

3. Në rast të vdekjes së shfrytëzuesit, bartjen e të drejtave dhe obligimeve nga Kontrata mund ta kërkojnë pasardhësit, anëtarët e familjes, ose nëse janë më shumë, personi të cilin e caktojnë pasardhësit ose anëtarët e bashkësisë familjare.

4. Pas kalimit të të drejtave të Kontratës, parapaguesi i mëparshëm mbetet përgjegjës për obligimet e krijuara deri në momentin e kalimit të të drejtave, kurse për obligimet e krijuara nga momenti i kalimit të të drejtave përgjegjës është Parapaguesi i ri.

14. Informatat dhe përkrahja e Shfrytëzuesve të shërbimeve

1. Shfrytëzuesi i shërbimeve e pranon që mts ka të drejtë që drejtpërsëdrejti t'i dërgojë njoftimet për ofertat e shërbimeve të mts-së si edhe shërbimet të cilat i ka zhvilluar mts me partnerët e vet kështu që këto shërbime i ofron bashkarisht me partnerin ose ua siguron përkrahjen e dhënies së shërbimeve partnerëve përmes rrjetit. Shfrytëzuesi i shërbimeve ka të drejtë të kërkojë ndërprerjen e dërgimit të mëtejshëm të mesazheve të theksuara përmes SMS, kodit USSD, duke e thirrur Qendrën për kontakte ose zyre të mts-së.

2. Mts në faqen e vet të internetit, përmes mesazheve SMS dhe kanaleve të tjera të komunikimit do ta kryejë informimin e Shfrytëzuesit të shërbimeve për çështjet e rëndësishme lidhur me dhënien e shërbimeve, siç janë: shuma e llogarisë, kërkesat e papaguara, paralajmërimet për limite, informatat për ndryshimet e Kushteve të përgjithshme, si edhe kushtit të dhënies së disa shërbimeve dhe etj., e të cilat nuk mund të karakterizohen si shpallje e drejtpërdrejtë e shërbimeve nga pika 1 e këtij paragrafi.

3. Njoftimet lidhur me ofertën e mts-së, me Listën e çmimeve të shërbimeve dhe me mënyrën e përdorimit të tyre, Shfrytëzuesit e shërbimeve mund t'i marrin në faqen zyrtare në Internet të mts www.mtsdoo.com, duke e thirrur numrin e Qendrës për kontakte 19933, përmes adresës së emailit: info@mtsdoonet, në zyra dhe në vende të tjera të shitjes së mts-së. Përkrahjen lidhur me përdorimin e shërbimeve shfrytëzuesit mund ta kërkojnë përmes numrave të njëjtë përkatësisht faqes së njëjtë të Internetit të mts-së.

4. Informatat për parametrat e cilësisë së shërbimeve shfrytëzuesit mund t'i marrin në zyra dhe në vende të tjera të shitjes si edhe në faqen zyrtare në Internet të mts-së www.mtsdoo.net.

5. Përveç në rastet kur me dispozitat e tjera të Kushteve të përgjithshme ose dispozitave të Kontratës është përcaktuar më ndryshe, Shfrytëzuesit e shërbimeve mund t'ia dërgojnë mts-së të gjitha njoftimet dhe kërkesat lidhur me përdorimin e shërbimeve dhe aplikimin e Kontratës duke përfshirë paraqitjen e mesazheve jo të

kërkuara, me dërgimin në adresën ose duke i thirrur numrat e theksuar në paragrafin 3, të kësaj pike, ose përmes tyre të marrin njoftime për mënyrën sipas së cilës dërgohen disa lloje të kërkesave.

15. Rregullat për kompensimin e dëmit Parapaguesit

1. Parapaguesi e paraqet në formën me shkrim kërkesën për kompensimin e dëmit në rastin e mosplotësimit të obligimit ose më vonë për plotësimin e obligimit nga ana e mts-së në adresën e shënuar në llogari. Kërkesën për kompensimin e dëmit Parapaguesi e paraqet brenda afatit prej 2 muajsh nga dita e krijimit të dëmit.

2. Nëse kërkesa e Parapaguesit do të aprovohet, dëmi do të paguhet me zvogëlimin e borxhit të Parapaguesit në llogari për çdo muaj gjithnjë derisa do të paguhet tërë shuma e dëmit. Dëmi mund të paguhet edhe në ndonjë mënyrë tjetër nëse këtë e kërkon kështu Parapaguesi, kurse mts pajtohet, ose në ndonjë mënyrë tjetër që është urdhëruar nga ana e gjykatës.

3. Parapaguesi nuk ka të drejtë për kompensim të dëmit:

- nëse është ndokush tjetër, e jo mts shkaktar i dëmit;
- në rastet e tjera në të cilat mts është liruar nga përgjegjësia sipas të gjitha dispozitave të Kushteve të përgjithshme.

4. Mts, në kufijtë e lejuar me ligj, nuk mban përgjegjësi për humbje indirekte, përfitimin e humbur, ose humbjen e të dhënave, as nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar me çfarëdo shfrytëzimi joligjor të shërbimeve ose me shkeljen e obligimeve kontraktuese nga ana e Parapaguesit ose nga personat e tretë me të cilët kjo është mundësuar me përdorimin e shërbimeve nga ana e Parapaguesit.

16. Zgjidhja e kontesteve

1. Mts dhe Shfrytëzuesi të gjitha kontestet e krijuara do të përpiqen që t'i zgjidhin me marrëveshje. Kontestet të cilat nuk mund të zgjidhen me marrëveshje, do t'i zgjidhë gjykata kompetente.

17. Dispozitat përfundimtare

1. Kushtet e përgjithshme, hyn në fuqi dhe aplikohen ndaj të gjithë shfrytëzuesve të shërbimeve të mts-së në ditën e publikimit të të njëjtave, dhe vetvetiu edhe ndaj të gjitha Kontratave aktive të lidhura para datës së publikimit.

2. Ditën e hyrjes në fuqi dhe me fillimin e aplikimit të Kushteve të përgjithshme, pushojnë të jenë të vlefshme Kushtet e përgjithshme për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik të rrjetit celular të Telekomit Serbia, të publikuara më 09.12.2015.